



Informacion për prindërit dhe kujdestarët

Kjo letër të drejtohet ty që je prind apo kujdestar i fëmijës në shkollën Kronan ose në shtëpitë e kohës së lirë (fritidshem). Letra është e përkthyer në gjuhë të ndryshme, por përmbajtja është e njëjtë, pavarësisht gjuhës.

Të enjten, më 22 tetor ka ndodhur një ngjarje e tmerrshme dhe tragjike në Kronan. Fëmijët, nxënësit dhe personeli janë të goditur në mënyra të ndryshme, dhe ngjarja do të jetojë edhe më tutje në kujtesën tonë për një kohë shumë të gjatë. Përkundër asaj që ndodhi, ne medoemos duhet për të shkuar më tutje, dhe përditshmëria do të na ndihmojë për ta bërë këtë. Kjo është arsyeja pse ne ju mirëpresim përsëri prapa në Kronan, kur shkolla rihapet në hënën më 2 nëntor.

Që nga ngjarja e së enjtes mësuesit dhe personeli nga Kronan dhe nga i gjithë qyteti Trollhättan, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë, kanë punuar për t'u përgatitur për ditën kur Kronan do të hapet përsëri. Ne mund të ju sigurojmë se ne do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për të krijuar siguri për fëmijët dhe nxënësit, dhe shpresojmë se ju prindërit dhe kujdestarët gjithashtu do të mund të jeni në gjendje të ndjeheni të sigurt që fëmijët e juaj do të merren nën përkujdes të mirë.

Për të pasur një rikthim të sigurtë në shkollë, ne i kemi ndërmarrë veprimet e mëposhtme. Kjo është ajo që do të vjelë më tutje.

- Dyert e hyrjes dhe hyrjet në Kronan do të ruhen. Gjatë kohës së mësimit, ne i mbyllim dyert me dry.
- Do të ketë rojtarë dhe personel të shkollës që do të lëvizin brenda dhe jashtë lokaleve të Kronan-s në mënyrë që të rritet siguria.
- Të gjithë fëmijëve dhe nxënësve që kanë nevojë për këtë do t'u ofrohet ndihmë dhe mbështetje nga pedagogët, kuratorët, psikologët dhe nga personeli tjetër i shëndetit të nxënësve.

Për të krijuar edhe më tutje qetësi dhe siguri për fëmijët dhe nxënësit, shkolla do të jetë e hapur vetëm për fëmijët, nxënësit dhe personelin e autorizuar. Prindërit dhe kujdestarët janë të mirëseardhur në kohën e lirë të Kronan-s (Kronans fritidsgård), ku gjithashtu do të ketë personel në vend për të ofruar bisedë dhe mbështetje

Orari për ditën e parë të shkollës – të hënën 2/11

09:00 Shkolla hapet për nxënësit të cilët priten në dhoma të mësimit dhe në lokale të zakonshme. Dreka shkollore do të servohet sipas orarit të rregullt. Prindërit dhe kujdestarët janë të mirëseardhur në objektin e Kohës së lirë të Kronan-s (Kronans Fritidsgård) .

13:00 Përfundon dita e shkollës. Kronan është e hapur për nxënësit të cilët dëshirojnë të rrinë aty edhe më tutje deri në orën 15:00.

Koha e lirë (Fritids) e zhvillon aktivitetin sipas orarit të rregullt.

Orari e martë 3/11

09:00 Shkolla hapet për nxënës. Do të servohet dreka shkollore sipas orarit të rregullt.

13:00 Dita e shkollës përfundon. Kronan është e hapur për nxënësit të cilët dëshirojnë të rrinë aty edhe më tutje deri në orën 15:00.

Orari e mërkurë 4/11

Që nga e mërkura shkolla zhvillon mësimin sipas orarit të rregullt.

Djeno Mahic
Rektor në Kronan

Birgitta Lundskog,
Shef i përkohshëm, Rajoni shkollor Qendra